



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 12, datë 10.11.2017

PËR

MIRATIMIN E SHTYRJES SË AFATIT TË LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN:
“NDËRTIMI I HIDROCENTRALIT “DRAGOBIA”,
KOMUNA MARGEGAJ, QARKU KUKËS”

Në mbështetje të neneve 27, 28 dhe 40, të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozim të shoqërisë “Dragobia Energy” sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e shtyrjes së afatit të Lejes së Ndërtimit për objektin: “Ndërtimi i hidrocentralit “Dragobia”, Komuna Margegaj, Qarku Kukës”, miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit Nr. 6, datë 08.04.2014, me subjekt zhvillues shoqërinë “Dragobia Energy” sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

DAMIAN GJIKNURI



SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOTA

